

FM MARBLE



PERSHKRIMI

Ngjitës me bazë çimento fleksibël për ngjitjen e pllakave të mermerit dhe granitit.

KLASIFIKIMI I PRODUKTIT

FM Marble është klasifikuar si C2te sipas en 12004, baza c çimento, 2 ngjitës me forcë ngjitëse të lartë, t rezistenca ndaj rrëshkitshmërisë, e kohë e zgjatur e punimit.

KARAKTERISTIKAT

- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- Për zonat e thata dhe me lagështi.
- Përmirësim i parametrevë të punës.
- Për fiksimin e pllakave mermerit dhe granitit në sipërfaqe të vështira.
- Për fiksimin e pllakave mermerit dhe granitit në sipërfaqe gipsi pasi është trajtuar me primer.
- Për fiksimin e pllakave mermerit dhe granitit mbi pllaka ekzistuese të vjetra.
- Për fiksimin e pllakave mermerit dhe granitit mbi dysHEME me ngrohje.

FUSHA E ZBATIMIT

FM Marble përdoret për shtrimin e pllakave mermerit dhe granitit, pllaka të dimensioneve të ndryshme 60cm x 120cm, 120cm x 240cm, 150cm x 300cm etj në sipërfaqe të ndryshme të tilla si: beton, veshje izoluese, çimento, suva, pllaka të vjetra, etj. Ky produkt është i përshtatshëm për brenda dhe jashtë. FM Marble gjithashtu mund të aplikohet në sipërfaqe të deformueshme si pllaka gipsi, druri, apo dysHEME me ngrohje qendrore nëse përfordhet me aditivin flexit, aditiv që përmirëson parametrat teknike të ngjitës.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Pluhur
Ngjyra:	Bardhe
Sasia e ujit per hidratim:	7.5 l/25 kg bag
Temperatura e aplikimit:	nga +5°C në +35°C
Spesori aplikimit:	do 20 mm
Koha e punimit:	te pakten 4 ore
Koha e punueshmerise:	45 min
Rreshkitshmeria:	0,1 mm
Mbushja e fugave ne mure:	pas 8 oresh
Mbushja e fugave ne dysHEME:	pas 24 oresh
Attaccando forza dopo 28 giorni a:	
• Kushte normale:	1,53 N/mm2
• Veprimin e nxehtesisene +70°C:	1,43 N/mm2
• Zhytjen ne uje:	1,51 N/mm2
• Ciklet ngrirje shkrirje:	≥ 1,53 N/mm2 ≥ 1,43 N/mm2 ≥ 1,51 N/mm2 ≥ 1,44 N/mm2
• Resistenza alla temperatura:	Nga - 20°C ne +90°C

Te gjitha matjet jane bere sipas standardit EN 12004.

MËNYRA E APLIKIMIT

Suportet tradicionale me bazë çimento duhet të kenë një kohë maturimi të mjaftueshme prej (28 ditë në temperaturë 23°C dhe u.R 40%). Suportet duhet të jenë të sheshta dhe të qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit. Suporti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i pastër e pa lëndë të huaja të tilla si: bojra, vajra, verniqe, material anti-ngjitëse. Pastrimi bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Suvatë përpara aplikimit të produktit duhet të kenë një maturim të paktën 1 javë. Suportet duhet të jenë mekanikisht të qëndrueshëm në funksion të qëllimit të përdorimit. Sipërfaqja e suportit ku do të aplikohet produkti duhet të jetë e pastër nga çdo lloj lëndë e huaj.

APLIKIMI

Për një aplikim sa më të mirë të produktit si dhe për të përfutur një shpërndarje të mirë dhe uniforme në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që fillimisht shtrimi i produktit mbi suport të bëhet me pjesën e drejtë të mallës, e më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Produkti duhet të aplikohet me një mallë të përshtatshme në varësi të tipit dhe përmasave të pllakës. Rekomandohet që mbas vendosjes së pllakës, të ushtrohet presion mbi të në mënyrë që pjesa e pasme të laget plotësisht. Në kushte të veçanta si: temperaturat e larta apo erërat e forta, dielli apo substrate me një absorbim të lartë të ujit që ndikojnë negativisht në performancën e produktit madje mund të ulin në mënyrë të ndjeshme kohën e hapjes dhe të korrektimit, ndaj për të mënjanuar probleme të tilla rekomandohet që suporti të spërkatet me ujë përpara aplikimit të ngjitësit ose të trajtohet me astarin dw primer. Gjithsesi në çdo rast është e rëndësishme që përpara shtrimit të places të kontrollohet nëse ngjitësi ka formuar cipë. Në një rast të tillë duhet të bëhet një rishpërndarje e ngjitësit për të riaktivizuar forcën ngjitëse të tij. Duhet shmangur derdhja e ujit mbi ngjitësin që ka krijuar cipë (është ngurtësuar) sepse në një rast të tillë formohet një shtresë anti-ngjitëse. Në rastin e veshjeve dhe dyshemeve në ambiente të jashtme sidomos në rastet kur pjesa e pasme e pllakave është me relief këshillohet që ngjitësi të përhapet edhe në pjesën e pasme të places edhe në suport në mënyrë që të mos krijohen zgavra (kavitete) në të cilat mund të penetrojnë uji apo të formohet lagështi e cila mund të shkaktojë më pas shqitjen ose edhe thyerjen e pllakave.

RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin e tij origjinal dhe të mbyllur, në zona të mbrojtura nga dielli dhe ngricat.

KONSUMI

4- 5 kg/m²

PAKETIMI

FM Marble është e mbushur në thasë letre prej 25 kg.

